

VENDIM
Nr. 92, datë 6.4.2021

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SHPK,
PËR TRANSFERIM TË ASETEVE (VENDOSJE HIPOTEKE, RISTRUKTURIM
KREDIE), NË FAVOR TË “INTESA SANPAOLO BANK” SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 20, pika “a”; nenit 44, pika “1”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 11, të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të Kushteve të Licencës, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; në mbledhjen e tij të datës 6.4.2021, Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 40/4 prot., datë 1.4.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve në favor të bankës “Intesa Sanpaulo Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 189, datë 19.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Me shkresën nr. 70 prot., datë 14.1.2021, shoqëria paraqiti në ERE kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, në pamundësi për ta plotësuar atë në afat, për shkak edhe të situatës së vështirë të krijuar nga COVID-19 dhe vonesave të shkaktuara për marrjen e dokumentacionit nga banka.

- Në lidhje me këtë kërkesë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 12, datë 20.1.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

- Më tej, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 127/1 prot., datë 10.2.2021, ka përcjellë një pjesë të dokumentacionit të munguar, duke mos ezauruar plotësisht kërkesat e rregullores së transferimit të aseteve.

- Në vijim të depozitimit për trajtimin në Bord të relacionit përfundimtar nr. 33/2 prot., datë 1.3.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Seman Sunpower’ sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke), në favor të ‘Intesa Sanpaolo Bank’ sh.a.”, në ERE mbërriti shkresa e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., nr. 127/2 prot., e ERE-s, datë 2.3.2021, me lëndë: “Plotësim dokumentacioni”.

- Duke qenë se shoqëria depozitoi dokumentacionin, i cili kërkonte kohë për njohje dhe analizim, në prag të përfundimit të afatit të vendimmarrjes së ERE-s, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 64, datë 4.3.2021, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, ristrukturim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., në mënyrë që të merrej koha e mjaftueshme për shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria.

- Vendimi nr. 64/2021 iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 127/3, datë 9.3.2021 dhe me shkresën nr. 127/4 prot. të datës 24.3.2021, me lëndë: “Vijim komunikimi”; ERE i kërkoi shoqërisë ndër të tjera listën e qartë të aseteve me vlerat përkatëse, si pjesë integrale të marrëveshjes që “Seman Sunpower” sh.p.k. ka nënshkruar me bankën.

- Shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k., me shkresën “Plotësim dokumentacioni”, të protokolluar në ERE me nr. 127/5 prot., datë 30.3.2021, ka paraqitur listën e aseteve të paluajtshme bashkëlidhur Kontratës së hipotekimit, me vlerën respektive.

- Nga analizimi i dokumentacionit të këtij aplikimi, në fazën përfundimtare të miratimit, duke marrë në konsideratë edhe sa plotësohet më parë prej saj në këtë aplikim (pasqyruar në relacionin nr. 33/2, datë 1.3.2021), dokumentacioni rezulton tërësisht i plotësuar, sipas kërkesave të parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”: plotësuar;

- neni 7, pika 3: plotësuar;

- neni 7, pika 4: plotësuar;

- neni 7, pika 6: plotësuar;

- Shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k. është mbajtëse e licencës me nr. 404, seria PV18, dhënë me vendimin nr. 86, datë 20.4.2018, të Bordit të ERE-s, për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas) me kapacitet të instaluar 2000 kw.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për transferim të aseteve (vendosje hipoteke, rishikim kredie), në favor të “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. (bashkëlidhur lista e aseteve me vlerat përkatëse).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkojë rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

Në bazë të aneksit 3, “Lista e aseteve”, më poshtë vlera e këtyre aseteve:

Emri i asetit	Vlera euro pa TVSH
Module Pv	763,940.33
Struktura	352,564.88
Inverter	213,993.27
Combiner box	116,015.27
Transformer	196,814.27
	1,643,328.00